Rregulla për Aplikim në Këshillin Vendor Rinor Prrenjas

- Aplikantët duhet të jenë të moshës 15–29 vjeç.
- Aplikantët duhet të jenë banues në territorin e bashkisë Prrenjas.
- Preferohen të rinjtë me përvojë në aktivitete rinore, vullnetare, sociale, kulturore, sportive, mjedisore ose komunitare.

Dokumentacioni i aplikimit

- Formulari i aplikimit i plotësuar.
- Kopje e dokumentit të identifikimit.

Mandati dhe angazhimi

- Anëtarët e përzgjedhur angazhohen të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet dhe aktivitetet e Këshillit Vendor Rinor gjatë mandatit dy vjeçar .

Barazia dhe përfshirja

- Procesi i përzgjedhjes do të garantojë përfaqësim të balancuar gjinor dhe përfshirjen e të rinjve nga zona urbane e rurale, si dhe të grupeve të ndryshme shoqërore.

Afati i aplikimit

- Aplikimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar në thirrjen publike nuk do të merren në shqyrtim.

Përzgjedhja

- Kandidatët do të vlerësohen nga komisioni i ngritur nga bashkia duke u bazuar në formularin që kanë plotësuar, vetëm kanditatët fitues do të telefonohen.

Detyrimet e Anëtarëve të KVR-së

- Të marrin pjesë në mbledhje dhe aktivitete.

- Të përcjellin shqetësimet dhe propozimet e të rinjve.
- Të kontribuojnë në hartimin e rekomandimeve dhe nismave rinore.
- Të respektojnë etikën, transparencën dhe bashkëpunimin institucional.